



TË DHËNAT PËR ASETIN Shitja e Aseteve përmes Likuidimit Nr.63 Njësia e Vendosur në Tender Nr.24 IT Proleter Lokali në Dardani	
Emri i NSh.-së	NSH "IT Proleter" Zrenjanin
Lloji i shitjes	Shitje përmes Likuidimit me ofertë të mbyllur.
Dita e Ofertimit	Më 18.10.2023 nga ora 10:00h deri 12:00h, në Sallën e Konferencave të "HOTEL GRAND" në Prishtinë.
Regjistrimi i Ofertuesit	Nuk ka parakualifikim
Depozita e Ofertës	25,000 Euro
Vendndodhja e Aseteve	Dardani, Rr. Kurrizi 5, Lamela 6, lokali 31a, Prishtinë
<u>Përshkrimi i Aseteve</u>	IT Proleter Lokali në Dardani , përfshinë sipërfaqen neto prej 134 m ² . Aseti gjendet në një pjesë shumë atraktive të kryeqytetit, në plato mbi Kurriz, Prishtinë.
Ndërtesat dhe tokat	Në bazë të marrëveshjes mbi bashkimin e mjeteve për ndërtimin e hapësirës afariste të lidhur midis ish BVI për Banim dhe OPPB (SOUR) Tekstil-Zrenjanin OP (RO) IT "Proleter" njësia punuese në Prishtinë, sipërfaqja e hapësirës është 326 m ² . Nga kjo sipërfaqe janë shitur disa pjesë para vitit 1999. Sipërfaqja prej 136 m ² i është shitur një pronari dhe pjesa tjetër prej 47 m ² një pronari tjetër.
Shfrytëzuesit	Vetëm hapësira e mbetur prej 134 m² sipas matjeve të realizuara në terren është pjesë e kësaj shitje.
<u>Përshkrimi i Aseteve</u>	Nuk ka tokë që do t'i bartet blerësit të ri.
Asetet tjera	Nuk ka.
Detyrimet që do të barten	Asnjë nga detyrimet nuk do të barten tek blerësi i ri, por sidoqoftë blerësi potencial duhet të ketë parasysh se mund të jetë i aplikueshëm tatimi për bartjen e pronës.



Foto/fotot
Ose informata të tjera
Për asetet në shitje



Informatat rreth Njesisë lëndë e shitjes të prezentuar në Te Dhëna nuk janë të garantuara. Investitorët potencial inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për të kërkuar dokumentet e tenderit. Ata të cilet dëshirojnë të paraqesin ofertë duhet të llogarisin në hulumtimet e tyre. Investitorët potencial këshillohen të bëjnë verifikimin e të dhënave vet para se të paraqesin ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të Dhëna janë në dispozicion nën kushtet e përgjithshme në informatat paraprake për informacione të publikut të gjerë për kandidatët e privatizimit, e cila mund të nxirret nga faqja e internetit të AKP-së: <http://www.pak-ks.org>.



Raporti i vizitës në terren

 AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Raport nga vizita në terren për Njësinë IT Proleter Lokal në Dardani

Data: 10.07.2023

Vizita e njësisë IT Proleter Lokal në Dardani në Prishtinë është bërë më 10.07.2023 ku prezantim i kësaj vizite ka bërë zyrarja kadastrale Blerina Kukaj dhe zyrari për shitje Hajredin Ramajli.

IT Proleter Lokal në Dardani përfshinë sip. Neto prej 134 m². Asoti gjendet në një pjesë shumë atraktive të kryeqytetit në plato mbi kurriz, Prishtinë.

Në bazë të marrëveshjes mbi bashkimin e mjeteve për ndërtimin e hapësirës afariste të lidhur midis Ndërmarrjes Publike Banesore dhe SOUR Tekstil-Zrenjanin RO ITC "Proleter", sipërfaqja e hapësirës është 326 m². Nga kjo sip. janë shitur disa pjesë para vitit 1999. Sipërfaqja prej 136m² është shitur një pronari dhe sjesa tjetër prej 47m² një pronari tjetër.

Vetëm hapësira e mbetur prej 134m² sipas matjeve të realizuara në terren është pjesë e kësaj shite.

Nga vizita e lartcekur është konstatuar si në vijim:

- Hyrja në lokal behet direkt nga platoja mbi Kurriz, në lagjen Dardania.
- Lokali është i lirë dhe nuk shfrytëzohet nga askush.
- Lokali është plotësisht i ndarë nga pjesët tjera dhe asnjë pjesë tjetër përveç asaj që është e përafruar me kësaj nuk është pjesë e Njësisë IT Proleter Lokal në Dardani.

Raportin e përgatitën:

 Blerina Kukaj Zyrtare Kadastrale, Zyra Rajonale Prishtinë Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)	 Hajredin Ramajli ZONA- Zyra Rajonale Prishtinë Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)
---	--

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) • Zyra Regjorale Prishtinë, Brr. Dritan Hoxha Nr. 55 10000 Prishtinë, Kosovë
+381 (0) 38 500 400 • www.pak-ks.org

Informatat

Departamenti i Marketingut, Marrëdhënieve me Publikun dhe Investitorët
Agjencia Kosovare e Privatizimit
Tel: +381 (0) 38 500 400 ext 1090, 2059
Fax: +381 (0) 38 248 076
www.pak-ks.org

Dokumentet e Ofertimit

Agjencia Kosovare e Privatizimit
Rruga: Dritan Hoxha, nr.55
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës